

“... Ç’është Shqipëria e tregon më shumë një kullë malësore, se të gjitha
bulevardet e kryeqytetit” - Indro Montanelli



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare “Dukagjini”, Viti i XII i botimit, nr. 134, dhjetor 2014

Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355683191817, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktor: Lazër Kodra, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

Gëzuar Krishtlindjen dhe Vitin e Ri 2015



U SHKËPUT NJË METEOR I GAZETARISË SPORTIVE

3



SHKODRES I DUHEN MEHMET SHPENDI DHE MARTIN CAMAJ

Dukagjin ka 25 vjet që realisht është unaza rrethore e Shkodër, madje edhe ajo pak popullsi që ka mbetur në malësi tani e pas do të jetë pjesë e Bashkisë së Shkodrës. Dukagjini gjithnjë ka qenë pjesë, politike, ekonomike, sociale dhe shpirtërore e Shkodrës. Dukagjini me sakrificë, privacione dhe flijime nuk pranoj tutelën e Begollajve të Pejës dhe zgjodhi për aleat Kara Mahmud Bushatin më të cilin i bashkonte bërthama gjenealogjike. Kyreparikët e maleve të Dukagjinit në mënyrë pragmatike (por edhe të pa drejtë në disa raste), kanë thënë se jemi me atë që ka Kalanë e Shkodrës. Thelbi i kësaj sentence ka qenë se Dukagjini nuk e ka parë kurrë vetën të ndarë as te armiqësuar me Shkodrën qytetin e tij lashtë. Kral Nikalla dhe gjeneralët e tij Veshoviqi, Kostandin Nikçi, Mil Spaci e deri tek ekspedita Jugusllave e vitit 1941, kurin e Kuq, në mënyrë demagogjike kur ...

5

“Dukagjini, rrugëtim në gjenezë”

Me datën 13 dhjetor 2014, në mjediset e bibliotekës “Marin Barleti” u zhvillua ceremonia e prezantimit të librit studimor-shkencor “Dukagjini, rrugëtim në gjenezë”, me autor Luigj Shyti. Kjo ceremoni u zhvillua sipas libretit të përgatitur nga Aleks Dushi dhe u drejtua nga dyshja aktori Tomi Delija dhe studentja Diana Bungu me mjaft elegancë dhe kombinim të pjesëve që ishin ...

9

Mundësoi Botimin:

GJERGJ LEQEJZA



REALIZIMET E VITIT 2014, BAZË E SIGURTË E REALIZIMIT TË PLANIT TË VEPRIMTARIVE TË SHOQATËS “ATDHETARE-DUKAGJINI” PËR VITIN 2015

Me punën e pa lodhur të anëtarëve të kryesisë dhe me mbështetjen e anëtarëve të Këshillit të Shoqatës dhe anëtarëve të saj, gjatë vitit 2014 janë realizuar një sere veprimtarish në bashkëpunim edhe me struktura të tjera të shoqërisë civile dhe kulturore, si me poshtë:

1-Gazeta “Dukagjini” në përgjithësi është botuar rregullisht në çdo muaj dhe ka dale numri 134 i saj. Janë bere përpjekje që ajo të shperndahet në Tirane, në Kurbin, në Lezhe, në Malësi të Madhe, në Shkodër dhe në Rrafshin e Dukagjinit.

2-Shoqata në bashkëpunim me Fototekën “Marubi” ka hap ekspozitën “Shan Pici-1938”, të fotografit Shan Pici, i cili ka bere fotografi në përgjithësi në zonën e Dukagjinit, e cila u realizua me 15 shkurt të këtij viti. Në këtë ekspozite pati një pjesëmarrje të madhe nga Shkodra, ishte dhe familja Pici, së cilës ju dorëzua titulli “Mirënjohja e shoqatës “Atdhetare-Dukagjini””. Në të njëjtën kohe ju dha titulli dhe Fototekës “Marubi” për punën që kishte bere.

E veçanta e kësaj ekspozite ishte pjesëmarrësi Ndue Deda nga Shoshi, i cili në vitin 1938 ishte fotografua nga Shan Pici dhe fotoja e tij fëmijë në atë kohe, ishte e ekspozuar. Dhe drejtori i Fototekës “Marubi” i dha një album me fotografi te Shan Picit

3- Me datën 25-26 prill një përfaqësi e shoqatës për rreth 40 vete morën pjesë në Manifestimin “Zëri i vëllazërimit-2014” në Rrafshin e Dukagjinit, në Peje, në Istog, në Kline dhe në Deçan. Në komunën e Klinës u bë promovimi i studimit shkencor e historik, me titull “Kultura e Komanit dhe komanasit”, me autor Ndoc Selimi, të cilit për punën e bere, ju dha dhe titulli “Mirënjohja e shoqatës Atdhetare-Dukagjini”.

4-Me datën 1 maj ishim të ftuar në 12 vjetorin e Muzeut “Shtjefen Ivezaj” në Tuz dhe ne u përfaqësua me 20 vete. Kryesia e Shoqatës, Shtjefen Ivezaj i dha titullin “Anëtar Nderi i Shoqatës”, sekretari i shoqatës, Luigj Shyti dhuroj disa libra nga botimet e tij, si dhe Zef Lulash Sokoli i dhuroj një xhamadan të punuar vete. Ata na bënë një pritje dhe respekt madhështor.

5-Me datën 17 maj, organizuam ne sallën “Kardinal Mikel Koliqi” dhënien e dokumentarit “Misteri i një Kreshte”, me autor Mhill Vaten.

6- Me datën 13 dhjetor 2014 u bë promovimi i librit studimor-historik e shkencor, me titull “Dukagjini, rrugëtim ne gjen-eze”, me autor Luigj Shyti

7-Gjatë kësaj kohe janë bere përpjekje për t’u miratuar nga Këshilli i Bashkise së qytetit tone, kërkesa e jone për sheshin e vendosjes së dy monumenteve, te njeri i atdhetarit Mehmet Shpendit-me rastin e 100 vjetorit të rënies së tij dhe tjetri i albanologut Martin Camajt, me rastin e 90 vjetorit të lindjes së tij. Pas shume përpjekjesh ai u miratua, fale kontributit të Mhill Prronit-anëtar i këshillit dhe anëtar i kryesisë së shoqatës dhe i mbështetur nga Ndue Marashi dhe av. Bardhy Lohja. Ky i fundit në cilësinë e kryetarit të këtij Këshilli.

Për të realizuar gjithë këto veprimtari është dashur një fond i caktuar. Dhe për këtë gjatë këtij viti janë arkëtuar 557 425 lekë, prej tyre 534 300 leke nga 14 mundësorë: Ndue Ftoni, me 2 000 \$, 203 300 leke; Gjergj Leqeja, me 143 000 leke; komuna e Pultit, me 52 000 leke; Kole Cardaku, me 50 000 leke; komuna e Rrethinave, me 18 000 leke; Bal Vuksani, Mark Zhuri, Gjergj Vocaj dhe Tonin Kamberi me nga 10 000 leke; Pal Lera, me 6 000 leke; Agron Hasani, Lulash Gjeloşi dhe Gjin Brigja, me nga 5 000 leke. Veçohen në këtë ndihmese Gjergj Leqeja, Ndue Ftoni, komuna e Pultit, Kole Çardaku dhe komuna e Rrethinave.

Këto fonde janë shpenzuar për nxjerrjen e gazetës, për marrjen pjesë në manifestimin “Zëri i vëllazërimit-2014”, në Kosovë, për hapjen e ekspozitës fotografike, në bashkëpunim me fototekën “Marubi”-Shan Pici-1938”; për marrjen pjesë në 12 vjetorin e hapjes së muzeut “SHTJEFEN IVEZAJ” në Tuz, për dhënien e dokumentarit “Misteri i një Kreshte”, me autor Mhill Vata, për promovimin e librit “Dukagjini, rrugëtim ne gjeneze”, me autor Luigj Shyti si dhe për mbajtjen e faqes së internetit të Shoqatës; për nevoja kancelarie të shoqatës e të tjera e të tjera.

E gjithë kjo pune e bere i dedikohet punës së palodhur të anëtarëve të kryesisë, të Këshillit të Shoqatës dhe degës së Tiranës, por në mënyrë të veçante falënderoj për punën e bere nga redaksia e gazetës me në

krye Lazer Kodra, seksionin e ekonomisë-financës me në krye Mhill Prroni, kryetaren për marrëdhënie me publikun-Dukate Bregu, Kryetarin e Këshillit të shoqatës-Prele Shytani dhe sekretarin e këtij Këshilli-Aleks Dushi; kryetarin e degës së Tiranës-Zef Bari.

*Me gjithë punën e bere ka pas dhe mos realizime, në veçanti në këto drejtime:

Me gjithë punën që është bere gjatë këtij viti, ende vihet re një pritshmëri nga kryetaret e seksioneve, vihet re një pritshmëri nga redaksia e gazetës, vihet re një pritshmëri nga kryetaret e degëve të shoqatës!? Nuk e di, sepse ndodh kjo, kur detyrat secili i ka të qarta ne statut dhe në programimin vjetor. Ky qëndrim nuk është i drejte dhe dëmtohen rende punën në realizimin e misionit të Shoqatës..

*Ende vijon te mbetet problem mbledhja e kuotave. Kryetaret e degëve nuk po e kryejnë detyrën e tyre, por edhe anëtarët e shoqatës nuk po e zbatojnë detyrën e tyre, që brenda muajit janar te çdo viti te dorëzojnë kuotën, detyrim statusor. Urojme që për vitin 2015 të filloje zbatimimi i këtij detyrimi në mbare anëtarësinë e shoqatës. Një anëtarë shoqate më tha një dite: Nuk po me merrem asnjëherë në Kosovë se, edhe unë jam anëtar shoqate. Po, i thash, ke të drejte, por nuk ke paguar asnjëherë kuotën, prandaj nuk e di se kujt ja kërkon përgjegjësinë e mos marrjes pjesë ne veprimtaritë e shoqatës?! U largua pa e zgjatë më tej. Sigurisht nuk më erdhi mire, por isha mbushe keq. Nuk vjen kryetari i shoqatës t’iu thotë jepni kuotën. Secili anëtar i shoqatës duhet të vijë vete pranë kryetarit të degës e ta dorëzoje kuotën brenda muajit janar të çdo viti. Po të ishte zbatuar ky detyrim statusor, ne do të kishim një zyre pune dhe nuk do sillleshim sa andej e këtej dhe duke u lut here njërit e here tjetrit që të na japin mundësinë të zhvillojmë një takim pune. Prandaj, ju kryetaret e degëve, ju anëtarët e shoqatës dhe ju anëtarët e Këshillit të shoqatës duhet të jeni promotorët e arkëtimit të këtij detyrimi statusor, megjithëse edhe ju e keni të vështirë! E keni të vështirë se, shumica prej jush nuk e ka paguar kuotën, se po të jeni ju mire me ligjin, do të ishit me aktiv. Kryetaret e degëve, seksionet e në kryesi, anëtarët e

Këshillit të Shoqatës duhet të jene me aktiv. Askush nuk i ka detyruar të bëhen pjesë e shoqatës, askush nuk ju ka detyruar të bëhen pjesë e drejtimit të Shoqatës, perverse detyrimi moral për ti shërbyer vendit të tij, për ti shërbyer komunitetit të tij. Mire kane bere, por ka edhe disa detyrime morale që duhen realizuar.

Kryesia dhe Këshilli i Shoqatës, që u mbledh me datën 5 dhe 12 nëntor 2014 diskutuan mbi disa probleme që ka pas shoqata gjatë vitit 2014:

1-Pozicioni i shoqatës pas reformës territoriale, pasi nuk ka një njësi vendor me këtë emër, me emrin Dukagjini. Pasi i diskutua, doli në përfundimin që shoqata duhet të marri përsipër një rol oponence me pushtetin vendor, me bashkinë e Shkodrës dhe me atë të Vau-dejës, në interes të komunitetit dukagjinas. Prandaj e shikoj të nevojshme të krijojmë një seksion për këtë qellim.

2- Një pune me e plote të bëhet me rininë dhe gruan.

3- Këshilli miratoi propozimet e kryesisë. Ne kryesi u zgjodh zonja Marie Fermosi, në detyrën e kryetares së seksionit të marrëdhënie me pushtetin vendor e deri atë qëndror; u zgjodh zonjusha Marinela Buxha në detyrën e kryetares së seksionit me gruan e rininë.

4-U tërhoq vëmendja për shpërndarjen dhe sigurimin e shitjes së gazetës “Dukagjini”. Në çdo muaj po del gazeta dhe Kryetaret e degëve nuk interesohen, me përjashtim të degës së Tiranës dhe asaj të Malësisë së Madhe. Ka dale e po zë rrënjë mendimi i gabuar, që ne jemi të detyruar të shërbejmë pa asnjë llogari. Një gazete që bën 30 leke, t’ua japim falas. Kjo nuk është e drejte. Kryetaret e degëve të punojnë dhe të sigurojnë leket e gazetës.

5- Për vitin 2015 do të punohet në baze plani të veprimtarive të miratuar nga Këshilli i Shoqatës, si më poshtë:

1-Vijimi i nxjerrjes së gazetës “Dukagjini” e cila duhet të dali në çdo muaj, të hënën e fundit të çdo muaji dhe me cilësi e përmbajtje sa me të mire të mundshme. Nga muaj shkurt 2015, redaksia të mendojë për ta nxjerre atë me 16 faqe, duke shkurtuar sasinë e kopjeve, nga 500 kopje që e kemi tani, në 300

kopje.

Në çdo muaj, Redaksia

2- Marrja pjesë në Manifestimin “Zëri i Vëllazërimit-2015” në Kosovë. Shoqata “Martin Dreshaj”, në vitin 2015 do të zhvillojë Manifestimin me datën 12-13 prill 2015. Në këtë date ata, do të festojnë 15 vjetorin i themelimit të saj. Ne, duhet të mendojmë se me çfarë mund të përfaqësohemi në këtë manifestim të veçantë të saj.

Muaji mars-prill 2015, Seksioni i veprimtarive kulturore e artistike

3- Marrja e masave për të përkujtuar 100 vjetorin e Qëndresës së Dukagjinit kundër Forcave Ushtarake malazeze dhe 90 vjetorin e lindjes së albanologut Martin Camaj.

Në këtë kuadër, do të ngrihen dy monumente, për atdhetarin Mehmet Shpendi dhe albanologun Martin Camaj ... Gjatë gjithë vitit do të vijoj zbatimimi i programit, por do të mbyllet në muajin korrik 2015.

Gjatë gjithë periudhës janar-korrik 2015, por ne veçanti muajit korrik, Grupi koordinator, me në krye Sekretarin e Shoqatës, Luigj Shyti

4- Një udhëtim neper vendet historike të zonës së Dukagjinit, me një grup studente të fushave të ndryshme, si: histori, tradite, arkeologji, etnografi dhe kulture materiale e shpirtërore,

Gjatë muajit gusht-shtator 2015, seksioni i gruas dhe rinise

Besoj në përgjegjësinë dhe në përkushtimin e anëtarëve të shoqatës, të anëtarëve të Këshillit të Shoqatës dhe në Kryesine e saj, prandaj jo vetëm që do të realizojmë detyrat në përgjithësi për vitin 2015, por në veçanti do të ndërtojmë dy monumentet, njërin për atdhetarin Mehmet Shpendi dhe tjetrin për albanologun Martin Camaj. Viti 2015 do te jete viti jubilar i Mehmet Shpendit dhe Martin Camajt. Duke u mbështet nga komuniteti dukagjinas kudo jetojnë, në Dukagjin, në Shkodër, në Tirane, në gjithë Shqipërinë dhe jashtë saj, do të ndërtojmë monumentet përkatëse dhe do të inaugurojmë në muajin e kulmit jubilar të tyre, në muajin korrik 2015.

NDUE SANAJ

Kryetari i Shoqatës
“Atdhetare-Dukagjini”

THETHI - emër që shfaqet në vitin 2134 para Krishtit

Pas marrjes së njohurive për emërtimin “Theth” në një territor të Pakistanit Lindor, në Punjab, që e kemi përmendur më parë, së fundmi gjejmë edhe emërtime të tjera, të tilla, në Indi.

Në pjesën juglindore të Indisë, në bregdetin e Oqeanit Indian ka dy vendbanime me numër të konsiderueshëm banorësh që quhen Theth. Banorët e këtyre vendeve kanë emigruar në Angli në masën 83%, ndërsa në Indi kanë qëndruar 17%.

Këta banorë flasin gjuhën e tyre amtare Tamil. Aeroporti më i afërt i tij është Karaikal rreth 13 km nga kjo qendër banimi. Qyteti më i rëndësishëm afër Thethit është Nagapattinam rreth 4 km. Plazhi më i afërt me Thethin është rreth 3 km. Popullsia e këtijë territori nuk ka asnjë lidhje me popullësinë e Thethit tonë, nuk ka asnjë të dhënë për këtë. Banorët e Thethit të Indisë janë shumë të interesuar për tu lidhur me të gjithë banorët dhe ish banorët më prejardhje nga këto territore, duke bërë thirrje nepërmas rrjeteve sociale.

Përveç atyre që kemi përmendur deri tash, del edhe një e dhënë interesante ku shfaqet emri “Theth”, në këtë rast si emër apo mbiemër njeriu.

Thethi si emërtim njeriu shfaqet në një Enciklopedi për Egjiptin e vjetër, të përgatitur nga Margaret R. Bunson në vitin 1991, botuar në gjuhën angleze dhe që është më i hershmi deri në sot i takimit të këtij emri. Kjo Enciklopedi ka 462 faqe. Sipas një artikullit të saj, në faqen 404, në vitin 2134 para Krishtit ishte një zyrtar i rëndësishëm i Oborrit Mbretëror të Egjiptit të vjetër me këtë emër, (ose mbiemër), i cili konfirmonte vdekjen e perandorit të asaj kohe dhe ardhjen në fuqi të perandorit pasues.

Me parë kemi folur për emërtimin e fshatit Theth dhe përmendur edhe emërtime të tilla në Pakistan. Tani gjejmë edhe në Indinë Juglindore, por gjejmë edhe emër njeriu “Thethi”, rreth 22 shekuj para Krishtit, në Egjipt. Nuk kemi mundësi për të bërë lidhjen e këtyre emrave dhe vendeve, por është shumë interesante dhe që duhet të tërheqë vëmendjen e studiuesve në këtë drejtim.


Një gjë është interesante. Kur u bënë regjistrimet e para nga Kadastra e Venedikut apo ajo Osmane nuk del në asnjë vend emri Theth, si toponim por as si emër njeriu.

Në vitin 1688 P. Coronelli bën një hartë të këtyre zonave dhe këtë vend e quan Theth. Kjo është përmendja e parë e këtij emri në Shqipëri. Emri Theth, si toponim, është shumë i bukur dhe shumë i veçantë në Shqipëri, Gadishullin Ilirik dhe Europë. Në të gjithë Shqipërinë, me sa kemi mundur të hetojmë, nuk kemi asnjë njeri me emër apo mbiemër “Thethi”.

Duke mësuar së paska një emër të tillë edhe në vende të tjera të botës, madje shumë larg është shumë interesante të studiohet se si qe e mundur që Coronelli të shkruaj këtë emër, pse e emërtoi kështu, si e gjeti, nga kush e mori, sepse

është shumë vështirë që të emërtohet një fshat, nga një njeri, me një emër dhe të jenë i qëndrueshëm. Nga kjo kohë nuk ka ndërruar më ky emërtim për Thethin.

Kemi dhënë disa mundësi për prejardhjen e emrit “Theth” kohë më parë,



Kopertina e Enciklopedisë

por duket se është e nevojshme që të mundësohet domethënia e këtij emri, kësaj fjale, në gjuhët e atyre që e përdorin, çfarë përmbajtje ka dhe çfarë pasqyron në këtë formë. Mundet që është një rastësi në lidhje me Thethin tonë, por që




Foto e dokumentit

(Thethi - fillim shek 22 para lindjes së Krishtit). Gjykata zyrtare e dinastisë së njëmbëdhjetë në Tebe. Ai shërbeu në sundimet e INYOTEF të parë (2134-2118 para lindjes Krishtit) dhe INYOTEF të dytë (2118-2069 para Krishtit). Thethi ishte oborrtari i favorizuar i thesarit mbretëror gjatë dy sundimeve. Në atë kohë INYOTEF-et sunduan vetëm Tebet dhe Egjiptin e sipërm.

STELA e Thethit, dokumenti i parë i regjistruar i asaj dinastie, përshkruan funeralin e INYOTEF-it të parë dhe ngjitjen në fron të INYOTEF-it të dytë. Thethi përgatiti varrin e INYOTEF-it të parë në Tebe. Ai u varros pranë INYOTEF-it të parë.)

të kenë disa vende, madje shumë larg, me këtë emër dhe disa familje që përdorin si mbiemër kjo është shumë interesante. Edhe në qoftë se ndonjë nga ushtarët e Aleksandrit të Madh kishte emrin Theth, ose vinin nga ndonjë vend me emrin Theth, dhe e bartën me vete ata që mbetën përgjithmonë në Pakistan apo Indi, këtu tek ne pse u shfaq kaq vonë, qe harruar, u zbulua, ndonjë përshtatje, apo ndonjë arsye tjetër.

Le të shërbejë, ky informacion, për humltime të mëtejshme, nga ata që kanë mundësi.

Luigj SHYTI

U SHKËPUT NJË METEOR I GAZETARISË SPORTIVE

Në muajin dhjetor 2014 ndërroj jetë pas një sëmundje të rëndë në moshën 38 vjeçare gazetari sportiv Mejdan Zhivani.

U lind në zonën e Nikaj-Merturit në një familje me tradita patriotike dhe atdhetare e cila në çdo kohë përqafoj të renë dhe progresin. Mejdani arsimin parauniversitar e mbaroj në vendlindje kurse shkollën e lartë në Shkodër fakulteti Histori-geografi.

Vdekja e Tij na befasoj dhe hidhëroj të gjithëve duke na mbush me trishtim e dhimbje.

Zoti e mori në mbretërinë e Tij për të qenë gjithmonë i ri, i dashur, i singhtë, punëtor, profesionist dhe me integritet të lartë ashtu siç ishte deri dje midis nesh. 38 vite janë pak për të jetuar një jetë, por plotësisht të mjaftueshme për të gdhendur një emër të dashur, të nderuar dhe të respektuar në hapësirën sportive mediatike shqiptare apo në mjediset ku jeton siç qe dhe do të jetë Mejdan Zhivani.

Vala e lëvizjeve demografike përfshiu edhe familjen Zhivani e cila zgjodhi Shkodrën e jo Tiranën si shumica e familjeve nikajmërturase duke qenë e bindur se në Shkodër do të ingrano-heshin më shpejt sepse Shkodra, Dukagjini dhe Nikaj-Mërturi kanë historinë e përbashkët, doket e zakonet afërsisht të njëjta etj.

Duke qenë Shkodra djepi i kulturës dhe sportit, ishte një mjedis që i binte për shtat edhe Mejdanit sepse kishte dhunti të lindura e të formuara për sportin në përgjithësi e futbollin në veçanti. Prandaj që në fillimet e jetës urbane iu kushtua gazetarisë sportive, në fillim në radio Shkodra, pastaj në televizionet lokale si TV-1 Cannel e TV Rozafa dhe së fundi në Radio-televizionin Shqiptar si telekronist në emisionin “nga njëra ndeshje në tjetrën” si dhe shumë aktiv në rubrikat sportive dhe median e shkruar. Tek ky njeri ishin të gërshetuara më së miri vetitë e virtytet më të mira të malësorit me edukatën qytetare në jetën urbane. Ishte fjalëpakë e punëshumë. Sikur mjaftë nxirrte nga goja ishte një enciklopedik i vërtetë. Kjo e ndihmoj në profesionin e tij duke i sjellë të gjalla figurat e ndryshme sportive të djeshme dhe të sotme, si dhe duke i bërë shumë tërheqëse e duke i sjellë shumë afër lexuesit apo dëgjuesit veprimtaritë e ndryshme sportive. Kishte aftësinë ta lezetonte ambientin duke qenë gjithnjë i qeshur, me humor të hollë, i dashur e bashkëpunues duke iu përshtatur gjithkujt.

Ishte një urë lidhëse dhe shtyllë bashkëpunimi midis gazetarive të Shqipërisë dhe Kosovës. Edhe mbas largimit nga Shkodra në Tiranë kontribuoj shumë për forcimin e lidhjeve dhe marrëdhënieve midis këtyre dy qyteteve në aspektin sportive e shoqëror duke qenë ideator i shumë veprimtarive të përbashkëta.

“Sa më shumë njoha Mejdanin, aq më shumë më shtoej dashuria për Shkodrën e njerëzit e saj “-u shpreh një koleg i Tij nga Tirana. Ishte njeri vizionar, tamam

Migjen i gazetarisë sportive.

Përmes fjalëve, dhimbjes, lotëve dhe përkushtimit për përcjelljen e Tij për në banesën e fundit, duken vlerat dhe vendi që zinte Mejdan Zhivani në shoqëri. Me përcjelljen që iu bë Ai mori pavdekësinë. Vdekja ogurzezë e mori në moshën më vitale duke lënë një boshllëk shumë të madh në familje, shoqëri dhe gazetarinë sportive.

Me një vendosmëri të pa shoqe, për një kohë të gjatë e sfidoj sëmundjen e rëndë e cila nuk e ligështoj duke e karakterizuar optimizmi deri sa e mposhti siç than edhe çetinën në shkëmb.



MEJDAN ZHIVANI

Ishte prind e familjar shembullor. Bashkëshortja Valentina dhe fëmijët Antonela e Ertiti duhet të gjejnë forcë për ta përballuar këtë humbje të madhe, duke e pas në jetë si model bashkëshortin e babin e tyre i cili do iu mungojnë fizikisht. Ata do të kenë në çdo kohë ndihmën e pakursyer të prindërve dhe vëllezërve të Mejdanit, të cilët manifestuan në këto ditë të vështira forcë e qëndresë. Dhimbjen ua lehtësuan edhe mijëra njerëz nga e gjithë Shqipëria e më gjerë, që morën pjesë në përcjelljen për në jetën tjetër siç e meritonte biri i tyre Mejdan Zhivani, i cili mbetet i madhërishtëm për veprën që la pas. Ai, gjatë do të mbetet në kujtesën tonë si njeri i ndershëm, kurajoz, studiues, punëtor e novator i palodhur në shërbim të familjes, shoqërisë dhe profesionit që zgjodhi të cilit i përkushtoi gjysmën e jetës.

Emri i mirë që Ai la pas duhet të shërbejë si burim force për familjen e të afërmit e Tij, për shoqërinë që e deshi aq shumë dhe për gazetarinë sportive te cilin duhet ta kenë si etalon në punën e saj.

I PËRJETSHËM QOFTË KUJTIMI I TIJ

Armando Cungu
Ajmir Grima
Arbër Shytani
Dëfrim Met’hasani
Gjergj Kola
Admir Uruçi
Gaspër Marku

FOTOLAJM

Festimi i KRISHTLINDJES në fshatin Nënmavriç, Komuna Shalë



SHKODRES I DUHEN MEHMET SHPENDI DHE MARTIN CAMAJ

Dukagjin ka 25 vjet që realisht është unaza rrethore e Shkodër, madje edhe ajo pak popullsi që ka mbetur në malësi tani e pas do të jetë pjesë e Bashkisë së Shkodrës. Dukagjini gjithnjë ka qenë pjesë, politike, ekonomike, sociale dhe shpirtërore e Shkodrës. Dukagjini me sakrificë, privacione dhe flijime nuk pranoj tutelën e Begollajve të Pejës dhe zgjodhi për aleat Kara Mahmud Bushatin më të cilin i bashkonte bërthama gjenealogjike. Kyreparikët e maleve të Dukagjinit në mënyrë pragmatike (por edhe të pa drejtë në disa raste), kanë thënë se jemi me atë që ka Kalanë e Shkodrës. Thelbi i kësaj sentence ka qenë se Dukagjini nuk e ka parë kurrë vetën të ndarë as te armiqësuar me Shkodrën qytetin e tij lashtë. Kral Nikalla dhe gjeneralët e tij Veshoviqi, Kostandin Nikiqi, Mil Spaci e deri tek ekspedita Jugusllave e vitit 1941 në Gurin e Kuq, në mënyrë demagogjike kur janë dukur në Dukagjin kanë deklaruar: **“Na lini të kalojmë. Nuk kemi as një të keqe me ju, por vetëm duam që t’i biem Shkodrës”**. Dhe Dukagjini nuk i ka lejuar kurrë që të kalojnë pa gjak aq me tepër që t’i bien Shkodrës pabesësisht pas shpine. Serbo malazezet kanë humbur dhe lënë robër mijëra asqer në ato male jo se Dukagjini kishte toka të buta, liqe dhe det aq të shumë lakmuara nga Carngia. Këto pasuri i kishte Shkodra, por Kral Nikolla e dinte mirë se demi zaptohet nga brirët dhe pa thyer Dukagjinin, Shkodrën nuk mund ta gëzonte kurrë. Një bust i Mehmet Shpendit, simbolit të qëndresës seromalazeze është vlerë historike për Shkodrën dhe Shqipërinë. Shkodrës i mungon një bust i Mehmet Shendit, pasi mendjendrituri i Pavarësisë Luigj Gurakuqi ndihet si një trup i gjymtuar pa krahë pa, ma Mehmet Shpendin dhe Dedë Gjon Lulin, ashtu si Mehmet Shpendi dhe Dedë Gjon Luli do ishin me nga një sy pa Gurakuqin. (Me ndarjen e re administrative është e pa kuptimet që Dedë Gjon Luli të mos ta ketë përmendoren në Qendër të Malësisë së Madhe me buzë tek kushtrimi e ballë tek flamuri). Luigj Gurakuqi, Mehmet Shpendi e Dedë Gjon Luli janë një Trimvirati historik i Lëvizjeve të mëdha patriotike, i fillim orkestrut të Pavarësisë. Luigj Gurakuqi, Mehmet Shpendi e Dedë Gjon

Luli janë koka dhe dy brirëshi i Dragoit të Veriut (Shkodër-Malësi e Madhe Dukagjin) simboli një uniteti, i një ëndrre, veprë dhe manifesti kombëtarë, përjetësisht të paharruar dhe te dobishëm edhe pas vdekjes. Shkodra qytetit më me tradita që edhe në kohërat më rënda të errësirës kombëtare



Martin Camaj

ka patuar gjithmonë të hapur një dritare evropiane. Shkodrës me ëndrra dhe prirje te vjetra dhe te reja evropianiste i mungon busti i Martin Camajt, poetit, e shkrimtarit që përfaqëson më se miri ketë tendencë. Shkodrës dhe Shqipërisë i mungon busti i albanologut Martin Camajt pasi askush më mirë se ai nuk na prezantoi në Evropë kur ne e kishim shpallur heretik. Shkodrës i duhet ky binom munometal për hedhur tej krahëve një farë inercie fanatike otomaniste që herë pas herë i shfaqet si flama në formën e një tendence të donkishoteske për krijimin heronjve “shpëtimtar” pushtues. Shkodra nuk mund të ekzistojë pa një ekulibër dualist (mes kryqit dhe kuranit), i cili fatmirësisht është ruajtur nder breza, por ka patur edhe krisje të xhindosura kur është vënë në rrezik, ky unitet. Rasti më tipik ka qenë në kohën internacionalitet, ku pati filluar një luftë e marrosur mes “Mollatarës” dhe “Sor-rës” së flamurit dhe Mehmet Shpendi ndërhyri në mes palëve duke shuar tymin e një zjarri Haxhi Qamilist që u tentua të ndizej Shkodër. Mehmet Shpen-

di, u rrit, u burrërua dhe plak në shërbim Shqipërisë, pushka e tij gjithë jetën qiti vetëm flakë lire. Mehmet Shpendin, nuk e ligështuan, as vendimet e Berlinit, as topat e Turgut Pashës, e kacaturret e Veshoviqit. Mehmet Shpendin e shpoi plumbi i pushtuesit shovinist por nuk e thej parja, as ari i as një të huaj.

Mehmet Shpendi na bën nderë të gjithëve. Mjerë për ketë vend! Mjerë për ketë popull kush e ka qeverisur e kush e qeverisë, kur akoma edhe pas 100 vjetësh nuk kemi një pjedistal për një hero kaq i dëlirë, që luftoi gjithë jetën si patriot, jetoj si fisnik dhe u flijua në mënyrë epike duke sfiduar legjendat. Për një popull në krizë të gjithanshme, në një tranzit të egër 25 vjeçar, në luftë për të rikonfirmuar identitetin e vet, një emër si Martin Camaj është një dhuratë qiellore, është një pasaportë shkëlqyer evropiane që na nderon si shqiptar. Por ç’ as i gjallë as i vdekur nuk po i behet vend në atdheun e tij. Qytetari i botës dhe shkrimtari të përmasave internacionale të vetmen dhuratë nga Shqipëria ka një rrasë guri (krye varri të lënë amanet) marrë vendlindja e tij Dukagjini.

DUKAGJINIT DUHET TË MOS QËNDROJ SI HERO I HESHTUR NË HIJE TË HISTORISË DHE I DËBUAR NGA JETA POLITIKE!

Në popull që nuk nderon heronjtë e vet, nuk meriton të quhet popull. Një shtet që nuk vlerëson korifejtë e kulturës së vet ose është lafitur ose është

gangster dhe imoral. Atë që duhet ta bënte shteti prej vitesh. Atë që duhet ta kishte në mend shteti i sotëm t’a materializonte për nderin dhe prestigjin e vet. Atë gjë sot Shoqata Atdhetare Dukagjini kërkon ta realizoj më ndihmën bujare te secilit dukagjinas kudo që të gjendet. Shumë dukagjinasit, falë inicia-



Mehmet Shpendi

tivës, shpirtit praktikë. mendjes novatore dhe duarve të shkathëta, kanë ngritur shtëpi, vila, palate, biznese. Të tjerë dukagjinas kanë fituar profesionet të dobishme, duke punuar me përkushtim, me luftë dhe sakrificë janë shkëputur nga kthet-rat e varfërisë. Akoma shumë dukagjinas luftojnë për mbi jetesë, dhe kjo për shkaqe diskriminuese shumë vjeçare ekonomike, politike regjionale. Jo pak intelektual kanë bërë emër në fusha të ndryshme të diturisë dhe kulturës, duke vazhduar traditën e mëparshme dhe lartësuar emrin e kësaj krahine. Vëllezër e motra dukagjinas, për veç bukës së përditshme, shëndetit dhe shkollimit të fëmijëve, sot për sot nuk ka detyrë më eprore përpara këtij komuniteti se konfirmimin i identitetit dhe vet përfaqësimit politik. Në se në vetë përfaqësimin politik kemi dështuar deri më sot lus zotin që të zëmë mend në të ardhmen! Ndërsa në ngritjen e këtyre dy busteve, nuk më besohet se do të dështojmë. Shpirti bujarë i dukagjinasit është minierë ari e pashtershme. Jam i bindur se nuk do dështojmë, madje

besoj do të krijojmë një traditë altruizmi edhe për të vlerësuar edhe shumë figura të tjera. Dukagjini ka natyrë fisnike dhe duke qenë fisnik, gjithmonë, as nuk i ka këndur shumë vetës, as nuk ka bërë reklamë historive, fatosave dhe artisteve të vet duke menduar se i përket shtetit dhe historisë që ta bëjë ketë gjë. Dukagjinit ndonëse me shumë vonësë duhet mos presë mrekullitë nga të tjerët, por të lartësojë vetveten dhe vlerat e veta. Dukagjinit duhet të mos qëndroj si hero i heshtur në hije të historisë dhe i dëbuar nga jeta politike. As kush më shumë se Dukagjini nuk i nderon te vdekurit me rite, darka mortore, një vjetore, vaje, varreza shumë të kushtueshme etj. Të nderuar vëllezër e motra, sikur vetëm gjysma e Dukagjinasve të kursejnë sa kushton kostoja e një vajëtori në varrimin e një të afërmi të tyre. Sikur të kursejnë vetëm njëqindmijë lekë të vjetra nga materialet e një varri (4-5 milionësh) apo shpenzimet nga një darkë mortore, do mjaftonin plotësisht për bustet e Mehmet Shpendit dhe Martin Camajt. Kemi varre shumë të bukura e madje tepër të kushtueshme, por nuk kemi as një monomet si komunitet sikur të ishim zonë jetime pa histori. Fëmijët tanë dhe të Shkodrës duhet ë ta perceptojnë atë që akoma nuk kanë të qartë vizualisht se kush janë Martin Camaj dhe Mehmet Shpendi. Nesër në Shkodër duhet behet e zakonshme shprehja, jam tek busti i Martin Camajt, apo takohemi tek busti i Mehmet Shpendit. Një Munomet për Mehmet Shpendin do gëzonte gjithë patriotet dhe fatosat dukagjinas ndër mote si Prel Luli Gjelo-sh Rama Marsh Tuci, Zek Jakin, Kolë Gjoni, Kolë Mark Kola, Xhur Kola, Sokol Tona, 7 shaljanët, Çun Nika, Marash Delia, Mark Milani, Babun Celi, Zef Dela, Çun Sokoli, Gjelo-sh Marku, Tomë Kola etj. Një Munomet për Martin Camajt do bënte të buzëqeshin gjithë elitarët dukagjinas si Profesor Kolë Prela, Lin Delia, Zef Mala, Ndrekë Luca, Pjeter Gjoka, Lec Shllaku, Benardin Palaj, Ferderik Reshpja, Prof Jak Marlekaj, At Gjon Shllaku, Gegë Lumaj etj. Një monomet për Mehmet Shpendin dhe Martin Camaj është një tapet i kuq që u hapë rrugën për në panteonin e zbra-zur që i pret në ardhmen gjithë këtë çete patriote dhe elitare.

102 Vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë festohen në një ditë në “The Imperial House”, në Michigan

Thanksgiving festohet çdo të enjte e fundit të muajit nëntor është dita e falënderimit të popullit amerikan. Kjo festë ashtu si dhe 4 korriku, dita e Pavarësisë së Amerikës është bërë festë e çdo shqiptari që jeton dhe punon në SHBA ashtu si dhe festat e tjera tradicionale shqiptare edhe këto festa të popullit dhe vendit amerikan festohen në mënyrë ceremoniale.

Duke qenë se Thanksgiving dhe Pavarësia e Shqipërisë afrojnë njëra me tjetrën në datë shpesh herë shoqatat dhe grupimet e shqiptareve në Amerikë i festojnë se bashku. Gjeli i detit i Thanksgivingit zbulon dhe pasuron tavolinat e çdo shqiptari në Amerikë. Pronari i “The Imperial House” biznesmeni Ndue Ftoni, kështu e kishte menduar këtë vit që të dy festat të luteshin në një ditë.

Nga Shqipëria i ftuar i Ndue Ftonit ishte dramaturgu i njohur shqiptar, Mjeshtri i Madh Fadil Kraja. Për nder të cilit pronari i ACTV-Televizioni i Komunitetit Shqiptar në Miçigan, njëkohësisht dhe i “The Imperial House” z. Ndue Ftoni një natë më parë i shtroi një darkë mirëseardhje z. Fadil Kraja së bashku me zonjën e tij të sapo mbërrit nga Shqipëria në Miçigan-mjeke Kraja. Në këtë darkë ishin të pranishëm stafi i televizionit dhe miq të afërm të zotit Ftoni dhe miku i dramaturgut, poeti nga Kelmendi, Gjovalin Lumaj.

Të enjten ishte ceremonia festive për nder të dy festive në sallën e madhe të Imperialit. Të pranishëm ishin shumë shqiptare dhe drejtues të shoqatave me aktivitet në Miçigan. Është bërë traditë në këtë ambient, qendre e madhe kulture për shqiptaret që festa të tilla të ketë hyrje solemne me flamuj nacional, atë amerikan dhe shqiptar dhe veshje tradicionale shqiptare.

Flamurtaret, zotërinjtë Vasel Ujkaj dhe Luvigj Sterbyçi shoqëroheshin dhe nga fëmijë të veshur të gjithë me kostume tradicionale shqiptare.

Pastaj ekzekutimi i himneve nacionale, atij amerikan dhe shqiptar ngriti në këmbë të pranishmit në shenjë respekti. Drejtuesi i aktivitetit pas ekzekutimit të himneve ftoi të pranishmit të mbanin një minutë heshtje në kujtim të të rënëve të nacionalitetit për pavarësi dhe liri, pavarësi.

Moderatori i aktivitetit Prof. Eduart Aliko, pas një prezantimi të shkurtër për të dy festat, njoftoi të pranishmit edhe për të ftuarit kryesor në këtë darkë solemne.

Ai ftoi pronarin z. Ftoni për hapjen e aktivitetit dhe përshëndetjen e rastit.

Zoti Ftoni në fund të fjalës së tij tha se: “Kam nderin që kam të ftuar të nderit në këtë darkë festive me ju të pranishëm, njeriun e madh të letrave shqipe, dramaturgun, Mjeshttrin e Madh Fadil Kraja”, të cilin e ftoi në podium dhe i dha fjalën atij.

Fadil Kraja pasi falënderoi të pranishmit dhe shprehu kënaqësinë e të qenit midis shqiptareve të Amerikës, vazhdoi me revokimin e historisë së lavdishme të nacionalitetit shqiptar. Ai në mënyrë impresionuese që mbërtheu sallën në përqendrim total, preku disa nga mo-



mentet kulmore të ngjarjeve historike të kombit dhe ajo që është padyshim dhe finalja e madhe, ngritja e flamurit në Vlore

me 28 nëntor 1912 nga plaku i mençur Ismail Bej Vlora. Padyshim që zoti Kraja nuk la pa falënderuar të zotin e lokalit

për ftesën dhe mirëpritjen e tij për të dhe bashkëshorten që e shoqëron në këtë vizitë të parë në SHBA.

Pastaj Manjola Dega (Tërshana) njëra nga prezantueset e programit festiv, ftoi në gjuhën angleze Kryetarin e Dhomës së Tregtisë “Gratiot Ave”, z. John Johnson, i cili përshëndeti të pranishmit, falënderoi të zotin e shtëpisë për ftesën. Dhe foli me superlative për bashkëpunimin me Iliria Telekom dhe pronarin e saj Dede Beleshi.

Në këtë festë përshëndeti dhe z. Eduart Grishaj, vizitor nga Shqipëria. Ai në fjalën e tij falënderoi komunitetin katolik dhe drejtuesin e kishës së Shën Palit që i kishin bërë ftesën e rastit

Përshëndeten, ish deputeti i Malit-Zi-Leke Lulgjuri (një nga themeluesit e LDK-se për Malin e Zi); Ndue Njebza, nenkampion i botes në mundjen stil i lirë dhe Nikolle Perkaj, luftëtar në Luftën Çlirimtare të Kosovës.

Recitimi emocional nga Ndue Gjekaj të poezisë për shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë u prit me duartrokitje nga pjesëmarrësit në sallë.

Grupi muzikorë i përbërë nga këngëtarët Gëzim Nika, Përparim Mefaja, Manjola Dega (Tërshana) dhe saksofonisti Gjovalin Shkreli shoqëroi të pranishmit deri pas mesnate.

Te veçantat e darkës festive....

Edhe pse një natë më parë në Imperial kishte koncert nga këngëtarët e njohur shqiptar, Eli Fara, Meda dhe Zef Beka dhe salla e koncertit ishte e mbushur plot me shqiptar prapëseprapë edhe në natën e dytë nuk munguan shqiptaret për të festuar. Në çdo tavolinë ishte një gjel deti i pjekur ashtu siç e kishte lajmëruar dhe pronari i lokalit.

Gazetari Zef Pergëga i dhuroj një tufe më lule trëndafili dramaturgut Fadil Kraja në shenjë respekti për mësuesin e tij.

Pronari Ndue Ftoni shprehu një falënderim special në fjalën e tij, për pjesëmarrjen e Alfons Grishajt dhe Kujtim Qafës në festë, respektivisht si eksponent kryesor të shoqatave “Vatra” dhe “Mirdita” me aktivitet në Miçigan

Drejtimi i aktivitetit për nder të festave kësaj radhe u ishte besuar më shumë se një moderatori. Televizioni ACTV-i Komunitetit Shqiptar në Miçigan e ndoqi aktivitetin dhe ishte ekskluzivisht nën regjinë e demonstrimin e mjeshtrit Paulin Palushi

Tavolina e Nënkryetarit të Shoqatës “Mirdita” në Miçigan-Bardhok Ndoj, që ishte edhe Kryetari i Listës së Shqipërisë Natyrale për Miçiganin Lekë Lulguri, edhe Kryetari i Fondacionit Vendlindja Thërrret-Luigj Gjokaj, edhe biznesmeni Leke Leci-një nga organizatorët e simpoziumit “Hoti në shekuj”, edhe nënkolonel Mark Gjonaj si dhe drejtuesi i AlbDreams.Net-kanë shoqëruar në kor dhe me zë të lartë të gjitha këngët patriotike të kënduara nga Gëzim Nika.

Përgatitë nga Rush DRAGU SHBA, Miçigan, me 27 nëntor 2014

Viktor Luigj Daragjati

Z. Viktor Luigj Daragjati lindi në vitin 1918 në Shkodër, në rrugicën e “Murgeshave Stigmatine” (ngjitë me shtëpinë e tyre) në Gjuhadol. Shtëpia e të atit, Luigjit, është pa kundërshtim më e vjetra në kohë, më autoktonja në stil, më e madhja në atë rrugicë dhe më e forta (në termetin e vitit 1979 thonë se nuk u ça si shumë shtëpi të tjera)

Viktori fëmëninë e kaloi me prindërit, dy vëllezër Paulinin dhe Zefin, dy motrat Matilden e Klore dhe shokët e lagjes. Shkollën Franceskane e kreu me rezultate të shkëlqyera. Në këtë periudhë mernte pjesë me shokët në korin e Kishës së Madhe (Katedrale) e cila është aq komode në kumbimin e zërave të ndryshme nga vetë arkitektura e saj.

Bashkëkohësit e mbajnë mend për zanin e tij të fortë e kumbues në këngët shkodrane, kishtarë e Spanjole. Këngët dhe gjuhën spanjole i kishte mësuar nga një familje Spanjole e cila kishte ardhë në Shkodër për strehim politik gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Me Z. Prenk Jakovën në piano, Z. Ndoc Shllaku në violinë e ky me zë me kitarë, formuan një orkestrinë moderne e të pelqyeshme për kohën. Merrnin pjesë në festa e në lokalet më të frekuentuara, bile në vitin 1945 edhe në Konsullatën Angleze në Shkodër, në rastet festive të saj. Ato arritën të regjistrojnë në pllaka

gramafoni në Itali, këngët popullore shkodrane, spanjole e italiane.

Gjate viteve të luftës, Vitori filloi shkollën për aktor në Romë në Çine Citta. Familja i ka të ruajtura fotografitë në kinoprovat e kësaj periudhe. Viktori e ndërpreu këtë shkollë se e kishte të pamundur të vazhdonte, për arsye të luftës. Ai në vitin 1944 ka qenë në burg të Prishtinës me shqiptarë të tjerë nga Shqipëria kundër gjermanëve si nacionalist.

Në vitin 1945 u arrestua sepse hynë me orkestrinë e tij në Konsullatën Angleze në Shkodër dhe për tradhëti sepse kishte thënë se kurrë në histori ylli i kuq s’kishte qenë në flamurin shqiptar. E kujtojnë këtë gjyq (ku u dënua me pushkatim), për fjalën e fundit që tha:

“Mëzgjidhni e pa kitarre due me këndue nje kangë spanjolle”.

Ndoshta ishte perballja e tij kryesore ma atë çfarë sjell kultura europiane.

Këngen e lane me e këndue e kuptohet që u pelqye nga e gjithë salla sipas atyre që ishin në gjyq. Gjyqi u përsërit dhe Viktori u dënua në 25 vite burg, kjo ne saje të ndihmës së një pushtetari të cilit ju dha një shumë parash të mbledhura nga familja. Burgun e bëri në Burrel, 12 vite deri në vitin 1957.

Kur Viktori u kthye në shtëpi, nuk gjeti baben, i cili kishte vdekur dhe as

të vëllanë Zefin të cilin e kishin pushkatuar (gjoja për krim ekonomik, qesharak, të poshtër për të mbuluar genocidin familjar të shkodraneve e shqiptarëve në lufte klasash, luftë me prejardhje fene, pronen, ditunitë e njerëzit në total.

Zefi u dënua në vitin 1954. Ai kishte kryer shkollën në Vjenë me të vëllanë Paulinin. Zefi ishte shumë i sëmurë (vuan nga tuberkulozi). Ekziston një letër të cilën një ditë para pushkatimit ja dergonte një kushërit të tij ku e pyeste për shokët e në fund shprehet:

Nuk e kisha mendue kurrë me e dashte aq shumë djalin!

Viktori, gjashtë muaj pas daljes nga burgu kërkoi punë shtetërore e private mbasi ishte edhe rrobaqepës, por nuk e lanë. Atëherë me djalin e axhës Njac Daragjatin i cili njihte zonën e Malit të Jushit e Velipojen, ikën me një barkë të vogël plot me njerëz nëpër Bune deri në Jugosllavi, mandej dolën në Trieste dhe në Madrid sepse kujtonin atë familjen spanjolle dhe dinin gjuhën.

Në Madrid punoj në Radion spanjolle si gazetar – spiker kuptohet me shumë në gjuhën shqipe për shqiptarët jashtë atdheut.

Kur u martua me Lekën, djalin e Mbretit Zog, Viktori si poliglot që ishte, lexoi në dasëm telegramet e urimit që kishin ardhë nga shumë vende të botës.

Gjithashtu këndoi në dasëm me kitarren e tij, këngë popullore shqiptare, që sipas gazetave pas vitit 1990 u pëlqyen shumë nga dasmorët



Viktori u martua me një grua suedeze, me të cilën nuk pati fëmijë. Me vonë i vdiq e shoqja. Ai vdiq në vitin 1984 nga kanceri në një spital amerikan afër Madridit e u varros në varrezat e Madridit afër një lumi.

Varret e familjes Luigj Daragjati janë në varrezat katolike të Rrmajit, Shkodër. Aty mungojnë eshtrat e Viktorit e Zefit, e ky i fundit ndoshta i ka prapa në bregun e lumit Kir me gjithëse fotografitë janë në varrin e familjes) Aty prehet edhe nana e tyre të cilën kur e pyesnin të njohurit si kishte mundësi që në një moshë 90 vjeçare të kishte trupin dhe shëndetin aq të fortë-ajo u përgjigjej: **“Vullnesa e Zotit”**. Quhej Katrina Koliqi Daragjati

Luigj Daragjati

TEORIA E BRRYLIT



Tregim me satirë e humor
Shyqyr Zotit koha u bë e bukur.
Shumë e bukur, ia ktheu Manushaqja.

Shaqe na mori malli! A po vjen të pijmë nga një kafe dhe të bëjmë pak muhabet, se besa ku rrijmë bashkë s’ka më lexet!

Ehu File ju kuptova! E di mirë ku e ke hallin! Mos u sill rrotull por bjeri drejtë e në temë! Thuaja motrës tënde si dhe pse e hoqen atë, i cili qyshkur s’mbahet mend ka qenë në shërbim të Telos së xha Komit.

Të gjithëve na pëlqejnë kuriozitetët! Ju kërkoni që unë të futem thellë në labirinthe e atij problemi, me fjalë të tjera të spjegoi fije për pe të famshmen “Teori e Brylit”, e cila bazohet në ekzistencën dhe bashkëpërimin e ndërsjelltë të dy “brylave” në lëvizjen e tyre të pandërprerë për të arritur objektiva madhore në zbatim të pikësynimeve djadhëzore!

Dakort,- tha ajo me zë të ulët dhe e përqëndruar në vorbullën e mendimeve të mjegullta, që e futen papritmas fjalët mbresëlënëse të Files.

Në këtë moment hyri në dhomë nusja e shtëpisë Gurabija me kafetë në tabaka, e bukur tophanë, doracake me sy e flokë të zezë deri në brez; faqet siç kuqëllo molla në gem, qafa gushë pëllumb dhe gjoksi i saj magnet menjëherë me ti marrë mendt!

Unë, - tha Shaqja,- nuk kuptoi çdo me thënë “Lëvizje e Pandërprerë”. Kam dëgjuar që brylat i përdorin vetëm kur zvarriten në tokë, ngjiten nëpër mure ose kalojnë në mes të një pylli të dendur shekullor.

Ju pastë Filja! Ne atje në ndërmarje kemi patur një shef, emrin e tij nuk po e them sepse ti e njeh mjaft mirë, i cili tërë jetën nuk u nda për asnjë moment nga llogaria e financa! Me 13 Mars 1997, kur qyteti u godit nga vala shkatërruese e anarkisë dhe e krimit, ai së bashku me rojen dhe dy punonjëse të qendralit qëndruan deri në fund në krye të detyrës duke rrezikuar jetën për mbrojtjen e pasurisë publike. Atë natë flakët e zjarrit, si përbindshat e Ferrit, mbuluan Bankën e Shtetit, Komisaratin e Policisë dhe disa objekte të tjera të rendësisë së veçantë, ku grupe banditësh me masaka në fytyrë dhe të armatosur me automatik e bomba kërkonin të shkatëronin çdo gjë që u dilte përpara!

Ishte fundi i vitit Dymijë e Një. Telegram nga Qendra: “...Të largohet menjëherë! Bilançi, Analiza dhe rezultati u takon të tjerëve.....! Atyrëve që nuk

kanë qenë dhe s’kanë punuar...! Qëlimi justifikon mjetin...! Teloja duhet të shkoi i qetë dhe i sigurt në duart e mister Tomit! “Pashai” ynë, - afërim i qoftë,- ka të drejtë kur thotë:” Ai ka vënë bark! Kështu siç është nuk menaxhohet...!Do ta bëjmë ndryshe! Me një gur vrasim dy zogj, ndoshta edhe tre! Interesi lëviz botën!”

Ne hapim “shtigje” të reja,- tha me zë të lartë Shaqja.

Tomi, - vazhdoi Filja,-do të gëzohet pa masë! Të dy palët dalin të fituar! Në procesin e tjetërsimit të kapitalit nuk ka të humbur! Po deshet mos e besoni! Do mbushen thasët me para! Ejvallah!

Ka halle qeveria! Gjumi i natës nuk e zën! Nuk është e lehtë të vijnë me dhjetra miliona dollarë si dhuratë nga “Qielli”?!

Në mes nesh të mbesin. Përfytyroni sikur të ishit juve në karrigët tona.

Pse njerëzit i kanë xhepat? Mos vallë për...?!

Përgatitë nga
Luigj Temali

NGA TETOVA NË DIBËR ME KËNGË POPULLORE

Në Pallatin e Kulturës së Tetovës publiku pati mundësinë të shijojë tingujt e këngës popullore qytetare. Edhe këtë vit, Tetova ishte nikoqire e edicionit të katërt të Festivalit të këngës qytetare “Teuta”, duke na dhuruar një program të pasur artistik me performanca nga trojet e ndryshme shqiptare.

Katër vite, katër edicione nuk janë pak për të fituar përvojë në aktivitete të këtij rangu, kështu që organizimi këtë vit kishte fituar jo vetëm eksperiencën, por edhe profesionalizëm. Fjalët më të mira u thanë nga të pranishmit, në radhë të parë për organizatorët.

Ngjarjet e këtilla normalisht organizohen me mbështetjen e institucioneve. Ministria e Kulturës së RM, Komuna e Tetovës dhe Qendra për Kulturë në Tetovë

Festivalin e organizoi Qendra Kulturore e Tetovës nën patronazhin e kryetares së komunës Teuta Arifi.

Padyshim, në edicionet paraprake, ky festival ka sjellë para publikut tetovar edhe shumë grupe tjera nga të gjitha hapësirat shqiptare, nga Elbasani, Prizreni, Pogradeci, Gjakova, Peshkopia, Shkupi, Struga dhe Gostivari.

Në skenë ishin: Kori “Teuta” nga Tetova, grupi “Lira” nga Korça, Ansambli i këngëve dhe valleve pranë Qendrës Kulturore “Pjetër Gaci” nga Shkodra, grupi “Xheladin Zeqiri” nga Tetova si dhe trupa artistike muzikore “Gjilani”, Republika e Kosovës.

Në këtë edicion para artëdashësve tetovar përformuan emra të afirmuar që bartin në zërin e tyre jehonën e thellë të këngëve të Shqipërisë së mesme, serenadave të famshme korçare, këngëve tipike të ahengut shkodran, këngën gjakovare dhe këngën qytetare të Tetovës.

Salla e tejmbushur e Pallatit të Kulturës mirëpriti dhe duartrokiti një nga një këta grupe virtuozë që me përformancat e tyre sollën në këtë ambient entuziast tetovarë këngën e bukur shqipe të disa prej qyteteve me shumë traditë në këtë fushë.

I papërshkrueshëm ishte momenti kur në skenë u ngjiti grupi i Qendrës Kulturore “Pjetër Gaci” nga Shkodra e Bik Ndojës, i cili u paraqit me një kolazh të zgjedhur me këngë popullore qytetare.

Qershia përmbi tortë ishte dalja pra publikut e këngëtarit “Mjeshtër të Madh” Bujar Qamili.

Mes duartrokitjeve të shumta Bujari falenderoi në emër të grupit organizatorët e festivalit si dhe qytetarët e Tetovës për mikpritjen e shkëlqyer. Më vjen mirë tha Bujari që organizohen festivale të tilla, pasi kur dëgjova grupet që konkuruan para nesh, m’u këndaq shpirti kur dëgjova këngë shkodrane. Sonte tha ai kam zgjedhur për ju një kolazh me këngë popullore nga perlat shqiptare së bashku me grupin e Qendrës Kulturore “Pjetër Gaci”, e cila ka ardhur shumë e përgatitur për të paraqitur para jush repertorin më të bukur të këngëve shkodrane.

Jehona e kësaj atmosfere u shtri edhe në darkën madhështore që të zotët e shtëpisë e kishin shtruar si një sofër të madhe në ambientet e restorantit Emka

Hotel ku kënga nuk pushoi deri pas mesnate.

Pas përfundimit të programit i morëm një intervistë edhe z. Jeton Pustina, udhëheqës artistik i festivalit dhe drejtor artistik: “Për të katërten herë me radhë mbahet festivali i këngës qytetare “Teuta” në Tetovë. Është një festival të cilin pretendojmë ta bëjmë tradicional, mbi të gjitha që t’i japë ngjyra qytetarie qytetit të Tetovës.

Për të katërten herë me radhë ky festival ka një rritje si në aspektin artistik ashtu edhe në aspektin organizativ. Gjatë

Një opinion rreth këtij festivali të organizuar me kaq madhësi në qytetin e Tetovës i morëm edhe z. Jetmir Rexhepi, dirigjent i grupit “Teuta”. “Grupi “Teuta” është bërë prej një grup grash. Para se me derigju grupin “Teuta” kam dirigju grupin e burrave, pastaj erdhi zonja Ramiye dhe zonja Qefajet dhe m’u luten që ta dirigjoj grupin “Teuta” të cilin e dirigjoj tash tetë vjet”.

Z. Jetmir, a mund të na thoni diçka për përformancën e Qendrës Kulturore “Pjetër Gaci” të Shkodrës, emocionet që ajo krijoi para publikut të mrekullu-



viteve mysafir kemi pasur Ansamblin “Isuf Myzyri” të Elbasanit, Pogradecin, grupin “Lira” të Korçës, grupin e këngëve të vjetra qytetare të Prizrenit, Strugës, Gostivarit e kështu me radhë nga të gjitha hapësirat shqiptare.

Këtë vit na kanë bërë një respekt shumë të madh Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” e Shkodrës, gjithashtu grupi “Lira”, Trupa muzikore artistike e Gjilanit, grupet nga Tetova, por mbi të gjitha është që të jemi bashkë artistët shqiptarë, ajo është simbolika më e madhe, por e dyta që të kultivohet dhe të vazhdojë të këndohet kënga e mirëfilltë shqipe. Për mua djepi i këngës shqipe është Shkodra dhe Korça. Ne, të gjithë bazohemi në ato dy shtylla, por edhe trevat e tjera kanë këngë shumë të bukura.

Unë besoj që në vitin e ardhshëm ky festival do të mbahet dy netë, jo një natë dhe përsëri të kemi mysafirë emblemat e këngës shqipe, grupe të cilët funksionojnë dhe ata që japin ngjyrën e qytetarisë këtij festivali”.

ashëm tetovarë? “Këtë grup ne e kemi thirrur edhe më parë që publiku tetovarë të dëgjojë këngët e bukura dhe jaret e mrekullueshme që Shkodra i ka”.

Ndërmjet qytetit të bukur të Tetovës të banuar nga shqiptarë autoktonë dhe qendrës së Dibrës, Peshkopisë, ekziston një kufi shtetëror, por për artistët nuk ishte as kufi imagjinar, sepse ato po vinin nga një qytet shqiptar në një tjetër po shqiptar.

Lidhjet e vjetra dhe të reja kulturore, artistike, muzikore, etnografike e historike nuk arriti dhe nuk do të arrijë t’i ndajë e t’i sfumojë një kontroll rutinë në kufi. Kultura shqiptare është një në të gjitha trojet tona.

Jemi në qytetin e Peshkopisë. Pemët e bulevardit kryesorë të ngjyrosura nga stina e vjeshtës, krijonin një ngrohtësi mikpritëse, ashtu të radhitura drejtë në dy anë e rrugës, sikur t’i thoshnin artistëve që erdhën “Mirëseerdhët në Odën Dibrane”.

“Oda dibrane” 2014, edicioni i 20 jubi-

lar, u zhvillua në qytetin e Peshkopisë. Për katër net me radhë, tre të zhvilluara në Pallatin e Kulturës Peshkopi dhe një natë në Pallatin e Kulturës të Dibrës së Madhe, kësaj krahine me kaq shumë histori, me kaq shumë kulturë dhe me kaq reputacion për vlerat e papërsëritshme në kulturën e gjithë hapsirës shqiptare.

Ishin 25 grupe pjesëmarrëse, me më shumë se 1000 artistë nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Presheva, që përformuan për artëdashësit dibrane, në të dy anët e kufirit, folkun e trevave nga vinin, me këngë e valle, duke treguar se këto vlera janë të afta të sheshojnë kufijtë administrativo-politik, sepse mbartin vlerat e tyre brez pas brezi.

Në bulevardin “Elez Isufi”, grupet pjesëmarrëse zhvilluan paradën e veshjeve, nën melodinë e këngëve e valleve të trevave nga vinin, të duartrokitur nga dibranët që kishin mbushur trotualet e bulevardit. Pjesëmarrësit e grupeve shprehen konsideratat më të mira për fest-folkun “Oda dibrane” 2014, si dhe mikpritjen dibrane. Në këtë natë konkuruan shtatë grupe, si dhe performoi edhe Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe Valleve, i cili kishte ardhur jashtë konkurimit të këtij festivali, për të përshëndetur jubileun e 20 të “Odës dibrane”. Ashtu si edhe në tre netët e para të zhvillimit të festivalit, njëra prej të cilave zhvilluar në Dibër të Madhe, edhe në natën finale, grupet pjesëmarrëse sollën në skenë këngë, valle, rite tradicionale të zonave nga vinin, duke ndezur artëdashësit dibrane, ku ra në sy Ansambli i Sharrit me riprodhimin e riteve baritore të kësaj treve, si dhe ata të dasmës baritore tradicionale e të papërsëritshme. Festivali “Oda dibrane”, i bërë i traditës tashmë dhe për nga vlerat që përçon në fest-folkun shqiptar, vjen pas atij të Gjirokastrës. Në fund, kryetari i jurisë së këtij festivali, prof. Zef Çoba, ndau çmime e diploma për individë e grupe të veçantë. Në fjalën e tij përshëndetëse ai e cilësoi festivalin e “Odës dibrane” një mozaik të shkëlqyer artistik.

Një moment shumë i rëndësishëm dhe që i gëzoi pa masë artëdashësit dibrane ishte dhënia e titullit “Mjeshtër i Madh” akorduar nga Presidenti i Republikës, Drejtorit të Festivalit, z.Veli Vraniçi, organizator në të gjitha festivalet e “Odës Dibrane” në vite, me motivacion: “Për kontribut të rëndësishëm si artist dhe organizator i festivalit mbarkombëtar “Oda Dibrane”, i cili me përkushtim dhe profesionalizëm në këto 20 vjet të kësaj veprimtarie, ka kontribuar në ruajtjen dhe promovimin e kulturës dibrane, duke i dhënë emër dhe vlera kulturore kombëtare”. Titullin ia dorëzoi në mes të brohoritjeve, sekretari i përgjithshëm i Presidentit të Republikës z.Arben Idrizi.

Si gjithmonë kjo odë e ngrohtë dhe mikpritëse bashkoi artistë më të mirë të muzikës popullore shqiptare, bashkoi aty muzikantë, studiues e krijues siç mund t’i bashkojë një dasëm e madhe.

Pergatite nga RAMAZAN ÇEKA



“Dukagjini, në rrugëtim në gjenezë”



para nesh punën e Luigjit, por edhe dha opinionin e tij për këtë pune studimore e shkencore.

Fjalën e mori Zef Lulash Sokoli, i cili jo verem ishte përgatitë seriozisht, por solli para nesh punën

e Luigjit dhe të shoqatës “Atdhetare-Dukagjini” në këto vite.

Alfred Haxhari, u ndal mbi punën që po behet për tu lenë brezave ato vlera që duhen trashëguar dhe vlerat e librit “Dukagjini, rrugëtim në gjenezë” në këtë drejtim. Bashkëfshatari i Luigjit, Zef Bari, vuri në dukje se Luigji vjen jo rastësisht me këtë pune, sepse ka dhe një tradite familjare. Baba i tij Gjergj Shyti, ka qene rapsod dhe lahutar i mire

Fjalën e mori dhe Ndue Sanaj, i cili ne

mes te tjerave u ndal ne vlerat studimore te librit.

Mjeshtri i Madh Fadil Kraja, vlerësoj shume Dukagjinin dhe dukagjinat kudo janë, dhe theksoj se ata janë të nderuar dhe të respektuar kudo që punojnë, nder të cilët përmendi Ndue Ftonin, i ftuar i të cilit kishte qene para pak ditësh në Miçigan.

Ne fund, ceremonia u mbyll me fjalën mbyllëse të autorit të librit, Luigj Shyti, i cili falënderoj organizatorët e ceremonisë

Me datën 13 dhjetor 2014, në mjediset e bibliotekës “Marin Barleti” u zhvillua ceremonia e prezantimit të librit studimor-shkencor “Dukagjini, rrugëtim në gjenezë”, me autor Luigj Shyti. Kjo ceremoni u zhvillua sipas libretit të përgatitur nga Aleks Dushi dhe u drejtua nga dyshja aktori Tomi Delija dhe studentja Diana Bungu me mjaft elegancë dhe kombinim të pjesëve që ishin përgatite për t’u paraqite në këtë ceremoni.

Pasi u recituan disa poezi të autorit nga botime të tjera të tij, fjalën e mori redaktori i librit profesor as. Dok. Zef Gjeta, i cili solli përpjekjet studimore e shkencore të autorit dhe kënaqësinë që ka ndjere gjate punës me këtë libër.

Pas tij, për pune studimore e krijuese të Luigjit, fjalën e mori studiuesi, poeti dhe publicisti Prele Milani. Gjate fjalës së tij solli para pjesëmarrësve punën studimore dhe krijuese nëpërmjet librit publicistik “Dukagjini ka vend për të gjithë” dhe librit etnografik “Gjurme”, vëllimet me këngë “të buta” të mbledhura dhe të botuara nga Luigji “Moj e mire n’ ortek të borës”. Ato mund ti paraqiste vetëm Prele siç e di vetëm ai, që jo vetëm solli



promovuese dhe grupin e drejtimit të saj, te nderuarin Aleks Dushi, aktorin Tomi Delija dhe studenten Diana Bungu. Gjithashtu falënderoi drejtorin e bibliotekës “Marin Barleti” për ndihmësen që na jep në realizimin e veprimtarive të shoqatës.

Ceremonia u mbyll me një koktej.

Këtë ceremoni e mundësoi Gjergj Voçaj, të cilin e falënderojmë me respekt!

Redaksia

poezi *** poezi *** poezi *** poezi *** poezi*** poezi *** poezi*** poezi *** poezi

HERNJVE TË KOMBËTARES
Turret Shqipja Dykrenare

Trojet tona trima rritën
vlon ndër dej gjak shqiptari
Në Beograd e mbrojtën shqipen
Fort tronditet Beogradi
Tuj luajt topin djem e Shqipes
po i dhunon Serbomadhi
Djemtë tanë s’ju tremben bishës
Mbi stadium duel Ismal Qemali
Ismal beu bashkë me shqipe
Përkrah tyre Is Boletini
Mbi stadium Shqipëria Etnike
ndalni dhunën se mirë na nihni
Djemtë e shqipes në fushë të futbollit
Mbrojtën Shqipërinë me flamur
Këta strënipa të Kastriotit
me dorzu nuk pranauan kurrë
Në mesazh botës mbarë
Ju dha Shqipëria në Beograd
Mos harroni Serbomadhja
Pra të bashkuar janë shqiptarët
Ky moment i historisë
Na bashkon në të katër ana
Tuj ja mbrojtë nderën Shqipërisë
Luftoj skuadra e Lorik Cana
Shkëputet trimi shpejt prej djemve
por si shqipja sulmon përpara
mor flamurin në dorë të serbeve
djali i Shkodrës Bekim Bala
Gjithë shqiptaret e Shqipërisë
Në mbrojtje të djemve qemë atë natë
la me gjak rrugën e lavdisë
nuk dorëzohen në Beograd
Me flamurin kuq e zi
turret shqipja jonë krenare
në botë shqiptare sot janë një
Në mbrojtje të skuadrës kombëtare
Ju jeni pjesë e lavdisë
në pediestal gjithmonë do rrini
përkrah jush populli i Berdicës
Bashkë me ju Benik Brahimi

RROK LAZRI, Berdicë

LYPSARI I VOGËL...

Shigjetë që t’ngulet n’shpirt është lypsimi
Shigjetë që t’shpon tejpërtej
E t’ha t’gjallë, n’vetvete, n’zemër, mosbesimi,
Kur shikon diellin e pashpirt,
Që djeg lidhëzat e këpucëve t’lypësarit t’vogël,
Atë erresirë mishzezë që hapë gojën drejt teje,
Të t’ hajë, të t’shqyej, zemrën duke t’gërryer.
Të ta shuajë edhe atë pakëz besim,
E t’japë një copëz KAFSH-atë mjerim.

Te kujtohet kur gënjeje
Se ishe bujar, kundër të ligës, trim,
Se kurrë jeta nuk do të kyçej në të tillë trishtim?

Fol para këtyre lypsarve të gjorë,
Që shtrihen në pluhur e llucë e nuk shkojnë në shkollë,
Që nuk dinë as sa vjeçe e kanë t’përvuajturën dorë.
Po dorën tënde sa vjeçe e ke, o mbret?
Dora që lyp është moshatare me dorën që vjedh e vret,
Po, vetëm ku Mbreti merr, lypsi digjet n’diell
Lahet n’shi e thahet n’erë.

Ti mbret që kalon këtu me makinë,
A nuk e sheh si e rrit rruga këtë fëminë?
Ka zgjidhje të thjeshtë, të mos jetë i gjorë e i varfër,
Mjaft që ti të mos qëllosh gjithmonë i pasur.

Jeta e njeriut pse kaq e pistë, e palarë?

Një qen jetim ecën rrugëve duke qarë...
S’ka ç’të hajë, rri me padronin e tij lypsar,
Qeshë edhe ai kur vogëlushit, një tjetër i varfër,
Diçka nga buka thatë, i falë.
As ky qen, as ky lypës s’kanë patur mundësi
Njëherë të vetme veten ta shohin n’pasqyrë.
Djersa e ketij lypsi hundën po ma vret,
Është stërvinë e pastër... di gjë pse m’duket si
Era e të pamëshirshmit mbret?!.
T’i shikosh te dy, qenin dhe lypсарin,
Nuk e di se cilin të gëzosh të parin...
Duken si një familje e mjeruar,
Të dy të hollë, pa mundësi për të jetuar,
Me të vërtet që Zoti beri mëkat të pafalshëm,
Pranoi varfëriminë, pa mbajtur anën e pastër,
Sa këta njerëz të mjerë,
Nuk e di sa shpesh janë penduar pse kanë lerë,
Pa pasur një herë mundësinë që të gëzojnë,
Lindën duke qarë, duke vajtuar jetojnë,
Do vdesin në rrugë, duke qarë me të madhe,
Me ata lot ngjyrë mjerimi, me lotët e shpresës në vete,
Se një ditë s’do trishtohen, s’do lypin,
N’trotuaret e një tjetër jete!
Pse gënjen edhe ti princ edhe ti mbret,
Sepse për vete të dy mendoni
Vetëm për një jetë.

T’i shikosh te dy, qenin dhe lypсарin,
Nuk e di se cilin të gëzosh të parin...
Duken si një familje e mjeruar,
Të dy të hollë, pa mundësi për të jetuar,
Me të vërtet që Zoti beri mëkat të pafalshëm,
Pranoi varfëriminë, pa mbajtur anën e pastër,
Sa këta njerëz të mjerë,
Nuk e di sa shpesh janë penduar pse kanë lerë,
Pa pasur një herë mundësinë që të gëzojnë,
Lindën duke qarë, duke vajtuar jetojnë,
Do vdesin në rrugë, duke qarë me të madhe,
Me ata lot ngjyrë mjerimi, me lotët e shpresës në vete,
Se një ditë s’do trishtohen, s’do lypin,
N’trotuaret e një tjetër jete!
Pse gënjen edhe ti princ edhe ti mbret,
Sepse për vete të dy mendoni
Vetëm për një jetë.

Nilidon Pepushaj,
klasa e 7-të b, Shkolla ‘Zemra e Krishtit’, Shkoder

ATDHE

Ke krijue shekujt, vitet, ditët e netët në emnin tand
t’pagzimit Shqipni.
Qielli yt asht pasqyrë
që sheh pertej hamendjeve t’horizonteve t’ngushta.
Mbretneshë mbi kombe!
Hape portën yjeve t’qiellit
t’ulën të kopshti i shpirtit tand,
në prehnin e nanës e t’flasin çiltësisht si bij.
E ju engjuj tokzorë!
Mbrojeni krenarinë tuej të shenjt
prej demonve t’ferrit
e vizatoni n’ univers
andrrën e mijëra gjeneratave,
që nuk mujten me ndeshë as me gishtin tregues
lumtuninë e ditëve të veshuna me diell.
Ati ynë që rri në qiell!
Ban që bekimi yt të shkrijë inatet e hyenive
e të ndertojë kshhtëjlla dashniye
n’shpirtin e trazuem të dimnave t’ftoftë
që puthen pabesisht buzët e përgjakuna të vendit tem.
Atdhe!
Je dashnia që lundron në oqeanin e pamatë t’shpirtnave,
Je zani i të ranve
Je përpjekja e përvetshme e ngadhnjimit tonë!
Ndoc Selimi, Milano

SHQIPËRI ATDHE I DASHUR

Shqipëri Atdhe i dashur
Si Ti nuk ka në Botë
Zemrat tona duan me të pasur
Më e mira në Evropë.

Bijtë e Tu jemi të gjithë
Në ball kemi një flamur
Përpara së bashku vëllezër e miq
Fatin tonë e kemi në duar.

Të bashkohemi pa dallim
Forca e jonë është Liria
Kemi shpresë kemi besim
Shpejt do të bëhet Shqipëria.

Kush guxon çdo rrethim çanë
Me punë dhe dije arrin planetët
Besën e burrave kemi dhenë
Mos të kursejmë as edhe jetën.

FLAMURI YNË

Larg në shekuj në histori
përmes luftës burrërore,
Yll Polar të patëm Ty
dhe do të kemi në çdo fitore.

Ke shqiponjen e Kastriotit
lur t’shpalosi në at nëntor,
pas errësirës qielli ndriti
lum drite solle në Vlorë.

Je burim i përparimit
të gjithë kombin e bashkon,
nderi yt besa e shqiptarit
porsi dielli kur agon.

O Flamuri Shqipërisë
zemrat tona i gëzon,
të valvit flladi i lirisë
drejt progresit na frymëzon.

LULËKUQES

Jehona e betejave
për ty Atdhe,
kur vjen pranvera
lajme sjell për ne.

Ngjyra kuq e zi
re që gjëmon,
dëshmorët për liri
ti na i kujton.

Lulëkuqe e majit
bukuri e radhë,
ajo pret djaln
me dashuri e mall.

Në mes të gjelbërimit
të ulur bisedojnë,
me ndjenjat e gëzimit
lulëkuqet i rrethojnë.

VJESHTA
Erdh shtatori iku vapa
dalëngadalë dita shkurton,
Ka fillu e zgjatet nata
shtëpitë tona i freskon.

Piqet rrushi, molla, shega
edhe misri vezullon,
s’ka më të bukur se sa vjeshta
plot me të mira na mbulon.

Male e fusha në çdo vend
me brilant janë mbulue,
me flori dhe argjend
baba Diell i ka krijue.

Ftohet moti dhe fryn era
një shterngatë po afron,
sa shpejt na iku Vera
radhën e saj lëshon.

Si papritmas diçka ndodhi
filluan pemët me u trondit,
gjethët e tyre në tokë i hodhi
shiu, era dhe stuhitë.

Luigj Temali

Marie Shllaku përmendore në Prizren, aty ku u pushkatua?!

Prizreni, u vesh me të zeza më 24 nëntor 1946, sepse në vendmbledhjen e intelektualëve shqiptarë në Lidhjen e Prizrenit (1878), por disa dekada më vonë u zhvillua gjyqi famëkeq dhe pushkatimi i katër martirëve shkodranë, midis të cilëve ishte edhe heroina e pamposhtur Marie Shllaku. Mëkati i saj i vetëm, për të cilën u vu para togës së pushkatimit ishte pse sokolesha e re e deshi me gjithë shpirt atdheun e saj. Natyrshëm lind pyetja retorike: A qenka mëkat të duash atdheun e të sakrifikohesh për të?! Nëse kjo do quhet mëkat, atëherë pse nderohen heronjtë, pse ngrihen memorial, pse përkujtohen vit pas viti, pse mbushen faqet e historisë me bëmat e tyre?! Marie Shllaku e deshi atdheun, më fort se gjithçka, zgjodhi të mos ishte si të gjitha femrat e tjera, pasi veshi xhamadanin e plumbave në vend të vellos së nusërisë, veshi opingat që t'i ngjitet malit, e strehë e saj ju bë, ashtu si foleja e shqipeve, hoqi dorë së ëndërruari.

Gjithmonë, është pak ajo që bëjmë ne, për të nderuar heronjtë, pasi ata bënë gjithçka që të bëhen shembulli jonë. Ky shkrim modest, le të shërbejë si kujtesë, për ata që harrojnë shpejt duke përfshirë dhe historianët. Për Marie Shllakun, janë shkruar disa vepra, si: “Shqipëria e Marije Shllakut” nga Ramiz

Kelmendi e Viktor Gashi (Prishtinë, 1995); “Marije Shllaku-Kosovë, gjaku im t’u bëftë dritë” Ibrahim Metaj, Tiranë 1995; “Marie Shllaku-Bijë e Shkodrës martire e Kosovës” nga Tomë Mrijaj, (Nju Jork, 2004); “Heroina Marije Shllaku” Shefqet Kelmendi (Tiranë, 2004) etj. Përveç librave monografikë, kujtimeve, janë mbajtur shumë kumtesa, në takime përkujtimore dhe simpoziume historike shkencore, janë shkruar artikuj publicistikë dhe mbajtur sipas rastit referate mbas viteve 1990...

Një rast i veçantë, është përkujtimi herëpashershëm, që revista “Jeta Katolike” (1966), organ i Kishës Katolike “Zoja e Shkodrës”, që botohej nën përkujdesin e Mons. Dr. Zef Oroshit, ka botuar disa herë artikuj përkujtimore, me përmbajtje të thellë historike për figurën e madhe të luftëtares së Shqipërisë Etnike, Marie Shllakun.

Sokolesha sypatrembur, u gjend kudo, ku e thirri zëri i atdheut dhe vuri gjithë kapacitetin e saj intelektual dhe fizikë, për të përmbushur detyrat e saj, pranë veprimtarëve të shquar kombëtarë, duke shërbyer si sekretare e patriotit dhe Ministrit të Punëve Botore Iliaz Agushi (1942), i cili, u vra me atentat terrorist nga komunistët, më 27 tetor 1943. Kurse më pas ajo ishte sekretare personale e Ministrit të Brendshëm Inxh. Xhafer Devës (1943-1944).

Miqësitë me personalitete të ndryshme e ndihmuan Marien, që të përftojë dije gjithnjë e më shumë. Kjo miqësi e ndërthurur me respekt e mirëbesim, u bë ujëdhësë e pjesëmarrjes së saj, në kuvende me rëndësi kombëtare, ku u morën

vendimet për çlirimin e atdheut, që ra në kthetrat e sllavo-komunistëve. Ajo, u lidh menjëherë me shtabin e luftëtarit Shaban Polluzha, ku më 20 janar 1945, ai u largua nga luftat vëllavrasëse, që ishin të dëmshme për kombin dhe iu bashkua forcave nacionaliste. Maria u zotua mes trimave të lirisë, që kishin ndërmarrë aktin sublime për shpëtimin e Kosovës martire, ku, shpreh: “Se duhet të luftojnë me tërë fuqinë pushtetin e komunistëve, mos të shkojnë me Serbi, të largohen partizanët e Jugosllavisë nga Kosova, sepse këto forca e kishin mbushur çdo pus të Kosovës me krerë shqiptarë. Në këtë drejtim, partizanëve të Serbisë, u erdhën në ndihmë edhe partizanët e Shqipërisë”.

Ajo u bë pjesë e pandashme me bajoraktarët dhe udhëheqësit nacionalistë, ku shërbej si një ndërlidhëse me vizion të qartë mes grupeve të Kosovës e Shqipërisë. Sërish nga sa kemi lexuar dhe hulumtuar në dokumente dhe shkrime, ajo del pranë nacionalistit të shquar legalist Abaz Kupit.

Shkodranja e re, e vetmja femër mes burrave më të shquar të Kosovës, u gjend gjithnjë në krah të nacionalistëve të kohës, si: Rexhep Mitrovicës, At Bernardin Llupi OFM, Ing. Xhafer Devës, Prof. Luan Gashit, Prof. Ymer Berishës, Ndue Përlleshit, Ukë Sadikut, Shaban Sadikut, Prof. Gjon Serreqit, Ibrahim Lutfiut, Mehmet Gradicës, Gjergj Dedës, Kolë Parubit, Gjergj Martinit e shumë luftëtarëve që kishin si qëllim të ngrinin popullin në luftë të armatosur kundër regjimit.

Shkodranja e dashuruar patologjikisht me Kosovën, iu përkushtua me gjithë qënien e saj, bashkimit të trojeve etnike, duke luftuar me armë kundër forcave komuniste. Ajo mori pjesë në Kuvendin e Drenicës, që ishte thirrur me qëllimin final shpëtimin e Kosovës nga pushtimi kolonizatorëve komunistët serbo-malazezë-shqiptarë.

Heroina, angazhohet për të organizuar një parti me emrin Lidhja Nacionale Kosova Etnike, duke u nisur nga inisiativa e fratit At Bernard Llupi OFM me 26 dhjetor 1944 e deri me 27 shkurt 1945, arin të themelohet Komiteti Demokratik Shqiptarë, që synonte krijimin e një rezistencë aktive kundër armiqve shekullorë serb. Madhështia e saj përveç në organizimin e rezistencës mbarëkombëtare nga Organizata

NDSH dhe Besa Kombëtare, do luaj një rol të rëndësishëm edhe në Kuvendin e Doberdolit.

Maria nuk u frikësua nga kërcënimet e komunistëve, për tu tërhequr nga aktiviteti atdhetar dhe mbi të gjitha nuk iu dridh qerpiku as para togës së pushkatimit. Si e kërkoi sigurimi Marie Shllakun?

Për herë të parë u zbardhën fakte të reja, se si Sigurimi i Shtetit komunist shqiptar bë bashkëpunim me atë Jugosllav UDB-në, përdori babain (Mark Simon Shllakun), për ta bindur të bijën (në Kosovë), që të kthehet në shtëpi (Shkodër). Në revistën shkodrane fetaro-kulturore “Kum-

bona e së Diellës” (Nr. 1-2 Janar-Shkurt, 2014), publicisti i mirënjohur Tomë Mrijaj, në një shkrim interesant, rrëfen kujtimet e të atit të tij Nikollë Pren Mrijaj (1911-1999), i cili i mundësoi takimin atë e bijë, në kullën e tij që ishte bërë

strehë e nacionalistëve kosovar (pasi Nikollë Mrijaj ishte kryetar i Komunës së Zllakuqanit).

Në veprën monografikë të z. Mrijaj lexojmë: “Me ardhjen në Kosovë të babait të saj, Mark Simonit nga Shkodra (i dërguar nga Qeveria e Komuniste dhe forcat e Sigurimit, që përndiqnin për t’i vrarë antikomunistët dhe nacionalistët e vërtetë asokohe, shënimi im T. M), për t’ia mbushur mendjen vajzës së tij të re, që të heqë dorë nga rruga e saj patriotike, në male, me çetat nacionaliste të Kosovës kishte lindur ideja, që Maria të vinte në shtëpinë tonë, ku ishte më e sigurtë”.

Në luftën e Siçevës, ditën e tretë të festës së Bajramit ku mbetën në betejë mbi 30 burra të zgjedhur të atdheut, ajo mori disa plagë në trup l shpëtoi rrethimit. Për fat të keq, ajo më vonë në fshatin Acarevë, në vitin 1945 u zu rob nga bashkëpunëtorët e UDB-së. Në procesin gjyqësor i zhvilluar asokohe, të gjithë që kanë qenë në burg e kujtojnë si një vajzë sokoleshë, ku me një stoicizëm qëndroi e paepur, para torturave shtazarake që u bënë çdo ditë kundrejt saj. Po atë ditë, vendimi për dënimin me vdekje (me pushkatim), ju dha dhe tre bashkëluftëtarëve të saj: At Bernard Llupi OFM, arsimtarit Gjergj Martinit dhe Kolë Parubit, të cilët disa ditë më vonë do të ekzekutohen, me 24 nëntor 1946 në Prizren, ku edhe sot në Kosovën e lire mjerisht ende nuk u dihen varret ... Si u zhvillua procesi gjyqësor i Marie Shllakut?

Sot Prizreni në gji të vet. Me xhelozin një skelet... Në të lashtin Prizren gjëmon historia Në të riun Prizren rron edhe Maria! Shefqet Kelmendi

Gjykimi i grupit të madh të lridashësve të vërtetë shqiptarë zgjati 13 ditë. Ai u mbajt në ndërtesën ish Shtëpisë së Kulturës, duke filluar nga data 29 qershor 1946 e deri me datën 11 korrik të vitit 1946. Asokohe prokuror i përgjithshëm ishte Ali Shukriu. Gjatë seancës përfundimtare të gjyqit, në listën e të akuzuarve ishin 27 nacionalistë shembullorë. Në këtë shkrim, duke i respektuar të gjithë dëshmorët e lirisë së Kosovës, po citoj vetëm të pushkatuarit, si: Marie Shllaku, 24 vjeçe; At Bernard Llupi, 60 vjeç; Kolë Parubi, 41 vjeç; Gjergj Martini, 29 vjeç, të gjithë ishin nga qyteti i lashtë i Shkodrës, të cilët u dënu-

an me pretendencë finale me 15 korrik 1946, ndërsa pushkatimi u bë në nëntor të po atij viti.

Prokurori antishqiptar Ali Shukriu e akuzoi (sikurse thuhet në veprën ish të burgosurve dhe bashkautorëve Ramiz Kelmendi dhe Viktor Gashit: “Shqipëria e Marie Shllakut...”, duke i renditur asaj aktivitetin “armiqtësor” (patriotik) në 11

pika.

1. Se në verë të vitit 1944, kur u vu në krye të Lidhjes së Dytë të Prizrenit Ing. Xhafer Deva, Marie Shllaku, ish sekretare e Ministrit të Punëve të Brendshme Iliaz Agushit, u zgjodh sekretare e tij. Këtë detyrë e ushtroi deri në nëntor të vitit 1944, kur u “çlirua” Kosova. Ajo, edhe pasi iku Xhafer Deva jashtë shtetit, mbeti në Kosovë, për të luftuar kundër “sistemit të ri shoqëror”.

2. Se në nëntor të vitit 1944, pas “çlirimit” të Pejës, e la atë dhe bashkë me Mehmet Gradicën, Metë Danin dhe Adem Shalën tuboi disa qindra shqiptarë të armatosur dhe bashkë me ata doli në mal, në mënyrë që, me luftë të armatosur në prapavijë të frontit, të luftojë kundër partizanëve dhe sistemit të ri, duke “penguar kështu ushtrinë nacional-çlirimtare të ndërtojë pushtetin popullor dhe të rregullojë kushtet në Kosmet”.

3. Se nga mbarimi i vitit 1944, duke njohur mirë njerëzit, që kanë pasur lidhje me Ing. Xhafer Devën të cilët kishin mbetur vetëm, për të vijuar luftën, kundër partizanëve në prapavijë. Maria, punoi për bashkimin dhe lidhjen e tyre të ndërsjellë, duke marrë kontakte me Ukë Sadikun dhe Ismail Goranin, prijës të “bandave” balliste, të cilët sulmuan Gjilanin, Ferizaj-n dhe vende të tjera.

4. Se në fillim të janarit 1945, pasi doli në mal dhe shkoi në Drenicë, punoi pareshtur për forcimin e radhëve të rezistencës, propagandoi që shqiptarët assesi të mos shkonin në armatën jugosllave, por të dilnin në mal për të zhvilluar luftë kundër partizanëve komunistë.

5. Se, po në janar të vitit 1945, mori pjesë në Kuvendin e Drenicës, ku gjen-deshin prijësit e njohur, si: Prof. Ymer Berisha, Mehmet Gradica, Ahmet Shala, Ukë Sadiku, Major Qiniqi, Shaban Pol-luzha, kapiten Rexhep Ismaili, Met Dine, major Kutova etj. Aty u vendos të sulmo-hen njësitë e ushtrisë nacional-çlirimtare në Drenicë dhe në minierën e Trepçës, si dhe u zgjodh udhëheqësia, që do t’i prijë kësaj lufte.

Lufta e armatosur, që pasoi pas mar-rjes së këtij vendimi zgjati shumë ditë dhe shkaktoi viktimë të rënda në jetën e njerëzve dhe në pasuri, betejë e cila ishte një goditje e rëndë për forcat tona, të cilat, asokohe zhvillonin lufta të rënda me gjermanët, në kufijtë e Sanxhakut.

6. Se, më të mbaruar Lufta e Drenicës e derisa u burgos, në vjeshtë të vitit 1945, vijoi me ngulm punën e saj në male me luftëtarët e rezistencës antikomuniste. Ajo mori pjesë në tubime të ndryshme me prijësit e tyre, ku, u morën vendime historike për të vijuar rezistencën me armë, dhe për të bindur popullin që të dilte në male, për t’u bashkuar luftëtarëve të Shqipërisë etnike; fshatarët t’i pranenin ato, t’i ushqenin, t’i mbanin dhe t’i ruanin në vatrat e veta.

7. Se mori pjesë në Kuvendin e Dobërdolit (mbajtur në Llugën e Dan Pjetrit), në gusht të vitit 1945, ku

ishin të pranishëm përfaqësuesit e të gjitha aradhave të armatosura anti-komuniste, në të cilin u zgjodh Prof. Ymer Berisha si udhëheqës politik, kurse Ukë Sadiku si udhëheqës ushtarak i gjithë luftëtarëve të

rezistencës në Kosovë, ndërsa vetë Marie Shllaku ka mbajtur procesverbalin e takimit historik.

8. Se mbajti lidhje të vazhdueshme dhe të pandërprera me Prof. Ymer Berishën, i shkroi letra, njësoj si dhe me prijësit e tjerë, si Ismail Ymeri etj.

9. Se mori pjesë në betejat kundër njësive ushtarake jugosllave dy herë me radhë, ndërsa në Luftën e Shëvës, aty nga gjysma e shtatorit 1945, u vranë në luftime 11 oficerë dhe ushtarë të armatës jugosllave (në këtë luftë Marie Shllaku, u plagos në disa vende).

10. Se gjatë gjithë qëndrimit të saj në mal mbajti lidhje të vazhdueshme me fratin e Pejës At Bernardin Lllupin OFM, ku, zhvilloi letërkëmbim me të, të cilët, u lidhën perms korrierit, dhe mori nga ai para, ushqim dhe mesazhe.

11. Se e akuzuara Shllaku, ndonëse e plagosur dhe e stresuar në një shtëpi në Mitrovicë, u interesua për bandat, mbajti lidhje me ato dhe u kujdes për tërheqjen e tyre jashtë kufijve të vendit, sipas vendimit të marrë më parë, duke bërë kështu krim, që sanksionohen në nenin 3 pika 7

dhe 12, të ndëshkueshme, sipas nenit 4 alineja 1 të Ligjit mbi Veprat Penale kundër popullit dhe shtetit". (Akuzat ndaj Marie Shllakut janë marr tekstualisht nga vepra e Ramiz Kelmendit dhe Viktor Gashit kushtuar asaj në faqet 15-17).

Mua mu duk e arsyeshme për t'i paraqitur akuzat ndaj Marie Shllakut, sepse kështu kuptohet dhe kontributi dhe aktiviteti i saj antikomunist, si dhe dalin në pah faktet se pse shihej si kërcenim personaliteti i saj për komunistët.

Marie Shllaku, do mbahet mend për heroizmat e saj. Është krenari të thuhet sot se vlerësimi i figurës së saj po bëhet dita-ditës, si në Kosovë dhe Shqipëri, ku po vihen emra rrugësh me emrin e saj. Ka ardhur koha që sot më shumë se kurrë kur njihet figura e madhe e Marie Shllakut ti ngrihet një përmendore në

Shkodrën e saj ku lindi dhe u rrit, dhe në Prizrenin historik ku u pushkatua në moshën e re 24-vjeçare.

Për këtë figurë të spikatur të historisë kombëtare shq-




iptare, posaçërisht hulumtoi dhe shkroi me përkujdesje të veçantë studiuesi dhe publicisti shqiptaro-amerikan Tomë Mrijaj (Sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes së Prizrenit qysh prej vitit 1978 në Neë York, shënimi im L. L.), që është dhe financuesi bujar i disa veprave, që janë botuar posaçërisht për Marie Shllakun.

Sekretari i Përgjithshëm i Lidhjes së Prizrenit në SHBA publicisti bashkëkohorë Tomë Mrijaj, së bashku me miqtë e tij Prof. Dr. Muhamet Shatrin dhe studiuesin Mr.sc Nue Oroshin zhvilluan një takim të ngrohtë me Komandantin e UÇK-së dhe ish Kryeministrin e Kosovës zotin Ramush Haradinaj-n (Gusht, 2014) ku, iu kërkua brenda mundësive të tij, që të nderohet shkodrانيا martire Marie Shllaku së bashku

me tre martirët e tjerë (At Bernardin Lllupin OFM, mësuesin Gjergj Martinin dhe Kolë Parubin), me një përmendore në qytetin e Prizrenit, pikërisht në vendin e pushkatimit të tyre.

Leonora LAÇI,
gazeta "SOT",
date 26 shtator 2014

ekspozita e librit *** ekspozita e librit ***ekspozita e librit ***



REDAKSIA

Kryeredaktor: Lazër Kodra
Redaktorë: Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Luigj Shyti, Suela Ndoja, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja

Kol Gjergj Kodra

Lindi në fshatin Gegaj të Komunës Shllak, Rrethi Shkodër, më 20 prill 1970. Pas arsimimit të detyrueshëm, mbaroi Shkollën e Mesme në Shllak, më 1990. Në vitin 2010 u diplomua

për Gjuhë-Letërsi në Universitetin "Luigj Gurakuqi" Shkodër. Nga viti 1993 deri më 1997 punoi mësues i Gjuhës dhe Letërsisë në ish Shkollën e Bashkuar Shllak. Ka shkruar poezi të cila janë botuar në gazeta të ndryshme lokale gjatë viteve 1994-1998.

Pas shkëputjeje të gjatë, më 2012 rikthehet tek poezia me vëllimin e parë "Vibrante". "Koha flet" është libri i dytë i këtij autori. Aktualisht punon në HEC-Koman. Vazhdon të shkruajë poezi.